



Data: 29 Dhjetor 2023

Për: Z. Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës  
Z. Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve  
Znj. Albulena Haxhiu, Ministre e Drejtësisë

Nga: Koalicioni i Organizatave për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF

Lënda: Letër e hapur - Shërbimet sociale rrezikojnë të mbyllen në Janar 2024

Të nderuar,

Koalicioni i Organizatave për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, i cili përfaqëson 35 organizata jo qeveritare, kërkon ndërmarrjen e masave të menjëhershme për parandalimin e mbylljes së shërbimeve sociale për fëmijët e cenuseshëm.

KOMF kërkon nga ju si Kryeministër i Republikës së Kosovës, Ministër i Financave, dhe Ministre e Drejtësisë, të ndërmerrni veprime në emër të përgjegjësisë kushtetuese për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, duke siguruar financimin për ofrimin e shërbimeve sociale, të cilat janë jetike për fëmijët e cenuseshëm, **shërbime të cilat si pasojë e mos mbështetjes financiare nga Qeveria rrezikojnë të mbyllen nga 1 Janar 2024.**

Shërbimet rezidenciale dhe shërbimet ditore për fëmijët pa përkujdesje prindërore, fëmijët viktimë të abuzimit dhe keqtrajtimit, fëmijët viktimë të dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit (niveli i ulët dhe i mesëm i rrezikut), fëmijët me aftësi të kufizuara, etj., financohen pjesërisht nga Ministria e Drejtësisë përmes thirrjeve publike çdo vit. Nga viti 2016, ka zbrazëtira kohore mes thirrjeve/kontratave për mbështetje të këtyre shërbimeve duke lënë pa përkrahje financiare këto shërbime çdo fillim vit. Institucionet jo-publike të licencuar për ofrimin e shërbimeve sociale janë mbështetur financiarisht nga Ministria e Drejtësisë për ofrimin e shërbimeve. Mbështetja financiare nga Ministria e Drejtësisë ka qenë për periudhën Prill 2023 - Janar 2024 dhe si rrjedhojë shërbimet posedojnë financimin vetëm deri në Janar 2024. Në mungesë të fondeve për mbështetje të mëtutjeshme shërbimet rrezikojnë të mbyllen.

Ndërprerja e ofrimit të këtyre shërbimeve, qoftë edhe përkohësisht do të lërë pa strehë fëmijët viktimë të akomoduar aktualisht në strehimore dhe po ashtu do të mbyllë derën për rastet e reja që mund të jenë në nevojë për shërbime rezidenciale, duke shkelur kështu të drejtën themelore të fëmijëve për mbrojtje.

Me situatë të njëjtë, do të përballen edhe ofruesit e shërbimeve që ofrojnë shërbime në baza ditore për fëmijët e cenuseshëm përmes qendrave ditore. Në mungesë të shërbimeve sociale, fëmijët e cenuseshëm, e sidomos fëmijët më aftësi të kufizuara do të mbesin të mbyllur në shtëpi dhe do të pësojnë regres në zhvillimin e tyre fizik, psikologjik dhe emocional. Kjo situatë, do të rëndojë edhe gjendjen ekonomike dhe emocionale të familjeve të fëmijëve të cenuseshëm, të cilët do të detyrohen që të marrin shërbime me pagesë, në bazë të mundësive të tyre financiare. Krahas mbylljes së shërbimeve, do të pasojë edhe mbyllja e qendrave të specializuara për shërbime ditore, të cilat janë të pajisura me mjete pune, infrastrukturë, staf profesional dhe të licencuar. Poashtu, ky vakum kohor, rrezikon humbjen e stafit profesional në të cilin është investuar ndër vite.

KOMF kërkon:

- **Ndërmarrjen e masave të menjëhershme për parandalimin e mbylljes së shërbimeve sociale.**
- **Ndarjen e një fondi emergjent për periudhën kohore Janar – Prill 2024, deri në hapjen e shpalljes së rregullt nga Ministria e Drejtësisë (fondi emergjent është praktikë që është ndjekur vitin e kaluar).**



Për të zgjidhur këtë problematikë të përsëritur ndër vite, KOMF kërkon ndërmarrjen e veprimeve për krijimin e një skeme të qëndrueshme për kontraktimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Kontraktimi duhet të bëhet në emër të blerjes së shërbimeve për ofrimin e shërbimeve sociale për periodha tre vjeçare në mënyrë që të sigurohet financim i qëndrueshëm dhe të eliminohen zbrazëtitë kohore.

KOMF bën me dije, në qoftë se nuk do ndërmerren masat e menjëhershme për parandalimin e mbylljes së shërbimeve për fëmijët e cenueshëm, do të shkelen rëndë të drejtat dhe mirëqenia e fëmijëve në Kosovë.

Prandaj, KOMF dhe organizatat anëtare, apelojnë ndërmarrjen e masave të menjëhershme lidhur me situatën e paraqitur më lartë.

Sinqerisht,

Koalicioni i Organizatave për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF

Aksioni për Nëna dhe Fëmijë  
Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim  
Balkan Sunflowers Kosova  
Childproof/CIPOF  
CONCORDIA Projekte Sociale  
Down Syndrome Kosova  
Education Comes First  
Handikos Ferizaj  
Handikos Gjakovë  
Hareja  
Network of Peace Movement  
Nevo Koncepti  
OPFAKKOS  
Organizata "Autizmi"  
Organizata Akti  
Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP  
PL4Y International  
Programi për të Drejtat Civile  
Public Organization for Local Initiatives and Supports – POLIS  
Qendra e Kujdesit Ditor PEMA  
Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT  
Qendra Labyrinth  
Qendra për Arsim e Kosovës – KEC  
Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të qenieve njerëzore  
Qendra për Studime të Avancuara – FIT  
Qendra Sociale Edukative SOS Kopshti  
Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë  
Save the Children në Kosovë  
SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë  
Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS  
Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova  
Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë – SDSF  
Terre des hommes  
The Ideas Partnership  
Voice of Roma, Ashkali and Egyptians – VoRAE